1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1*
- c. *Sigurimi i ofertes, (nëse është i zbatueshëm) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;*

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 7/1;

e. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor),

3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

1. Ofertuesi duhet të jetë kompani sigurimesh, e cila të përmbushë të gjitha kërkesat e Legjislacionit të fushës, e pajisur me leje për ushtrim të aktivitetit sigurime dhe/ose risigurime nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, ku të jenë specifikuar qartë grupet/klasat për sigurimet e kërkuara në këtë tender dhe ne specifikimet teknike.

3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të lotit.

2. Kopje të çertifikuara të balanceve të viteve: 2016, 2017, 2018, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

3.3 Kapaciteti teknik:

1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 30% të vlerës së fondit limit.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon dokumentacionin si më poshtë:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) Fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Sigurimi i shëndetit të studentit specializant.

Shuma e sigurimit: mbrojtje deri 1,000,000 lekë për person

Afati kohor - 1 vit kalendarik

Numri i të siguruarve - Pasqyruar në tabelë dhe mund të ndryshojë me lëvizjen e specializantëve.

Numri i studentëve specializantë

Nr.	Emërtimi	Njesia	Nr. i specializanteve		Total Nr i specializantëve	Nr.Ditë per tu siguruar për çdo st.specializ.
			FM	FMD		
1	Sigurimi i Shëndetit të specializantëve/studentëve gjatë ushtrimit të detyrës/Mbrojtje deri 1,000,000 lekë	Persona	576	22	598	366
		Persona	80		80	183
		Persona	17		17	305
		Persona	5		5	246

Pozicioni i punës - specializante

- *Kërkohet edhe primi ditor me të njëjtat limite përgjegjësie.*

1. Përkufizime.

‘**Aksident ose Aksidental/e**’ do të kuptohet një ngjarje e menjëhershme, e papritur dhe e paparashikueshme që ndodh rastësisht dhe e paqëllimshme, ngjarje e cila ka impakt trupor të drejtpërdrejtë, të jashtëm dhe të dhunshëm mbi specializantit që do të sigurohet, që rezulton me humbjen e jetës ose paaftësi të specializantit që do të sigurohet, brenda 12 muajsh nga data e ngjarjes.

‘**Dëmtimi trupor aksidental/e**’ do të kuptohet dëmtimi trupor i specializantit nga një aksident që ndodh brenda periudhës së sigurimit, i shkaktuar vetëm dhe drejtpërdrejtë nga shkaqe aksidentale dhe që brenda 12 muajsh nga data e këtij aksidenti rezulton në humbjen e jetës, dëmtimin trupor ose paaftësi për punën e specializantit.

‘Aksident në punë ose për shkak të punës’ është dëmtimi i menjëhershëm trupor, i ndodhur gjatë kryerjes së punës ose gjatë një procesi i cili ka lidhje me punën, si dhe çdo dëmtim tjetër i shëndetit, që sjell paaftësi të përkohshme ose të përhershme në punë ose vdekje. Aksidenti vlerësohet se ka ndodhur në punë ose për shkak të punës, kur specializanti dëmtohet:

- a) gjatë kryerjes së punës së zakonshme;
- b) gjatë kryerjes së një pune tjetër, pa urdhër të punëdhënësit, por për arsye madhore në interes të punës;
- c) gjatë kryerjes së një pune tjetër, me porosi të punëdhënësit;
- d) gjatë kohës së pushimit, në vendin e caktuar ose për vënien në rregull të makinerive, veglave të punës, veshmbathjeve, para ose pas mbarimit të punës;
- e) gjatë rrugës, në linjën e drejtpërdrejtë, nga banesa për në punë dhe anasjelltas;
- f) në rastet kur transporti është i organizuar nga punëdhënësit dhe kur ai është individual;

‘Përfitim’ do të kuptohet shuma e përfitimit në tabelën e përfitimeve për kategorinë përkatëse të humbjes, e pagueshme nga Siguruesi sipas kushteve të kësaj policie.

‘Fillimi i sigurimit’ do të thotë periudha kohore e policës e përcaktuar, në bazë të të cilave kjo policë është operative.

‘Datë efektive’ do të cilësohet data kur polica do të mbulojë çdo specializant të siguruar.

‘Person i Siguruar’ do të thotë specializant pranë Fakultetit të Mjekësisë, i cili është përfshirë në këtë policë, ose çdo ndryshim të kësaj police, që në ditën e parë të “Datës Efektive”.

‘Humbje gjymtyre’ do të thotë, humbja dhe shkëputja fizike e një dore nga kyçi ose një këmbë nga nyja dhe që përfshin humbjen e plotë dhe të pakthyeshme të përdorimit të një dore, krahut ose këmbë.

‘Humbje e jetës’ do të thotë humbja e jetës së specializantit të siguruar, gjatë kohës që polica e sigurimit do të jetë në fuqi.

‘I/e përhershëm/e’ do të lidhet me paaftësinë që zgjat në afat kohor mbi 12 muaj dhe në përfundim të tyre nuk ka shpresë përmirësimi.

‘Paaftësi e pjesshme e përhershme’ do të thotë humbje e aftësisë për punë e specializantit, e shkaktuar nga një aksident i cili do të rezultojë:

- a) me humbje të plotë anatomike,
- b) me humbje të përhershme funksionale të një ose disa organeve ose gjymtyrëve të specializantit, siç përcaktohet në ‘Tabelën e Përfitimeve’.

‘Paaftësi e plotë e përhershme’ do të thotë paaftësi që zgjat të paktën 12 muaj të njëpasnjëshëm

dhe e cila e ndalon plotësisht specializantin të ndërmarrë çdo lloj punësimi për të cilin ai është i aftë nga arsimi, trajnimi apo përvoja, për të gjithë jetën kur nuk ka shpresë përmirësimi.

‘Policëmbajtës’ do të thotë Autoriteti Kontraktor i identifikuar si i tillë në formular si edhe student I cili do të disponojë policën në momentin e lidhjes së saj.

‘Policë’ do të thotë marrëveshja e nënshkruar nga palët, të cilat së bashku përbëjnë të gjithë policën.

‘Shumë sigurimi’ do të thotë shuma maksimale e përfitimit, e pagueshme për specializantin që është siguruar. (specializanti që sipas kësaj police lidhet me:

- a) humbjen e jetës;
- b) dëmtimin trupor;
- c) paaftësinë aksidentale të personit të siguruar.

‘Paaftësi e pjesshme e përkohshme’ do të thotë, humbje e pjesshme e përkohshme e aftësisë së specializantit për të punuar ushtruar detyrat, shkaktuar nga një aksident që rezulton me dëmtim trupor, i cili e ndalon përkohësisht specializantin që të ndërmarrë çdo punësim, ushtrim detyre për të cilin është i aftë nga arsimi, trajnimi ose përvoja (ose nëse nuk është i punësuar çdo lloj punësimi të pagueshëm).

‘Paaftësi e plotë e përkohshme’ do të thotë humbje e përkohshme e aftësisë së specializantit për të punuar, ushtruar detyrat, shkaktuar nga një aksident që rezulton në dëmtim trupor të specializantit, e që e ndalon përkohësisht specializantin që të ndërmarrë çdo lloj punësimi për të cilin ai është i aftë nga arsimi, trajnimi apo përvoja (ose nëse nuk është i punësuar çdo lloj punësimi të pagueshëm).

2. Fillimi dhe përfundimi i mbulimit të sigurimit

2.1 Mbulimi në sigurim për sa i përket çdo specializanti të siguruar, do të fillojë në Datën Efektive dhe do të përfundojë me ndodhjen e më të hershmes prej ngjarjeve vijuese:

- a) Kur kjo policë përfundon në përputhje me afatin e përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit dhe policës së sigurimit;
- b) Data në të cilën specializanti i siguruar pushon së qeni i tillë pranë Fakultetit të Mjekësisë Tiranë.
- c) Data e përfundimit e vendosur në Formular.

2.2 Përfshirja dhe heqja automatike nga mbulimi në sigurim

Kjo policë do të mbulojë automatikisht me sigurim, të gjithë specializantet e siguruar si dhe të gjithë specializantet e rinj, prej datës së fillimit të punës në varësi të njoftimit të dhënë Siguruesit nga

Fakulteti i Mjekësisë.

Mbulimi përfundon në datën e përfundimit të sigurimit ose punësimit..

3. Përfitimet

Në vartësi të parashikimeve, kushteve e përjashtimeve të Policës së Sigurimit, me marrjen dhe miratimin e provës, Siguruesi do t'i paguajë specializantit të siguruar/ përfitimin:

- Në rast të '**Humbjes së jetës**' së specializantit të Siguruar nga një aksident: *Shumën e sigurimit.*
- Në rast të '**Paaftësisë së plotë të përhershme aksidentale**' të specializantit të Siguruar nga një aksident që ndodh ndërsa polica është në fuqi: *Shumën e sigurimit.*
- Në rast të '**Paaftësisë aksidentale të pjesshme të përhershme/të përkohshme**' nga një aksident që ndodh kur kjo policë është në fuqi: *Përfitimin sipas Tabelës së Përfitimeve në vijim:*

Tabela e Përfitimeve

(në % ndaj shumës së siguruara)

a) Humbje jete	100	
b) Paaftësi e pjesshme e përhershme	djathtë	majtë
c) Humbje totale anatomike dhe funksionale e:		
• Gjymtyrës së sipërme mbi brryl	70	60
• Një dorë ose parakrahu	60	50
• Bllokimi i plotë i kyçit të dorës	40	30
• Gishtit të madh të dorës	18	16
• Gishtit tregues të dorës	14	12
• Gishtërinjë të tjerë të dorës	8	6
• Gishtit të vogël të dorës ose një gisht i këmbës	12	10
• Një falangë të gishtit të madh të dorës	9	8
• Një falangë të gishtave të tjerë të dorës	1/3 e gishtit	
• Një këmbë mbi gju		60
• Një këmbë poshtë gjurit		50
• Bllokimi i plotë i kofshës deri në mes		40
• Bllokimi i plotë i përdorimit të këmbës në nivel të nyjes		30
• Gishtit të madh të këmbës		5
• Çdo gisht tjetër të këmbës		3
• Një falangë të gishtit të madh të këmbës		2.5
• Një falangë të gishtave të tjerë të këmbës		1
• Humbje e plotë dhe e pakthyeshme e shikimit të një syri		50
• Humbje e plotë dhe e pakthyeshme e dëgjimit të një veshi		10
• Humbje e plotë dhe e pakthyeshme e dëgjimit të dy veshëve		40
• Shpretkës		10
• Një veshke		30
d. Paaftësi e plotë e përhershme		

• Humbje e plotë dhe pakthyeshme e shikimit të dy syve	100
• Humbje e plotë fizike dhe funksionale e dy ose më shumë gjymtyrëve së bashku	100
• Sëmundje mendore e plotë dhe e pakurueshme	100
• Paralizë e plotë dhe e pakurueshme	100
• Paaftësi e plotë e përhershme	100
e. Paaftësi e plotë e përkohshme (për javë)	0.5
f. Paaftësi e pjesshme e përkohshme (për javë)	0.15

Kushte të veçanta

Siguruesi paguan përfitimin për pasojat e drejtpërdrejta dhe ekskluzive të shkaktuara nga aksidenti. Në rast humbje anatomike ose reduktim të funksionit të një organi ose gjymtyrë të dëmtuar, e cila ka qënë dëmtuar para ndodhjes së aksidentit, përqindjet e mësipërme do të zvogëlohen duke marrë parasysh paaftësinë e mësipërme. Llogaritja do të jetë zbritja e thjeshtë aritmetike ndërmjet përqindjes së paaftësisë aktuale dhe përqindjes së paaftësisë së mëparshme.

Në rast se rrjedhojë e aksidentit është reduktimi, por jo humbja e plotë e funksionit ose gjymtyrës, për sa i përket përcaktimeve të tabelës së mësipërme përqindjet e mësipërme do të zvogëlohen përpjesëshmërisht me shkallën e humbjes anatomike apo funksionale. Llogaritja kryhet në mënyrë të ngjashme me paragrafin e mësipërm.

Nëse pasojat e aksidentit do të rëndohen nga ndonjë gjendje ose paaftësi fizike e specialistit të siguruar, e cila ka ekzistuar para ndodhjes së aksidentit, atëherë shumën e çdo përfitimi të pagueshëm do të jetë shumën që konsiderohet në mënyrë të arsyeshme që do të ishte paguar në rast se kjo pasojë nuk do të ishte rënduar në këtë mënyrë.

Në rast se specialisti i Siguruar është mëngjerash përqindja e përfitimit (nën treguesit ‘djathtë’ ose ‘majtë’) do të shkëmbehen në mënyrë që përqindja më e lartë e përfitimit të zbatohet për dorën/këmbën e majtë dhe pjesët e tyre.

Siguruesi ka të drejtë absolute të përcaktojë përqindjen e pagueshme për çdo paaftësi të përhershme që nuk është përcaktuar në Tabelën e Përfitimeve.

Në rast se specialisti i Siguruar pëson disa humbje të ndryshme anatomike ose funksionale (që nuk përfshijnë njëra-tjetrën), përfitimi total i pagueshëm do të duhet të jetë i barabartë me shumën e përqindjeve të paaftësisë së çdo humbje, por jo më shumë se 100% e shumës së sigurimit.

Mbulim shitesë

Mbytja në ujë dhe nga gazi e tymi helmues.

Ndërsa kjo policë është në fuqi, në rast se specialisti i Siguruar humbet jetën ose pëson paaftësi të plotë të përhershme si rrjedhojë e mbytjes në ujë ose nga gazi e tymi helmues, do të paguhet shumën përkatëse e përfitimit të përcaktuar në Tabelën e Përfitimeve, me kusht që ky dëmtim të mos jetë pasojë e veprimeve të qëllimshme të specialistit të Siguruar.

4. Përjashtime

Siguruesi nuk do të jetë përgjegjës të paguajë për dëmtime/humbje që janë pasojë direkte ose indirekte e:

- a) Luftës, pushtimit, veprime të armikut të jashtëm, luftimeve (pavarësisht nëse është deklaruar luftë ose jo), luftës civile, rebelimit, revolucionit, revoltës, kryengritjes.
- b) Reaktorit bërthamor, rrezatimit bërthamor ose ndotjes radioaktive, pavarësisht nga burimi i tyre.
- c) Ekspozimit të qëllimshëm të Personit të Siguruar ndaj rreziqeve të larta (përveçse në përpjekje për të shpëtuar jetë njerëzore) ose veprimeve kriminale të vetë Personit të Siguruar.
- d) Dehje, përdorim të tepruar të lëndëve psikofarmaceutike, drogave dhe halucinantëve.
- e) Vetëvrasje ose tentativë për vetëvrasje.
- f) Dëmtime trupore të vetëshkaktuara.
- g) Pjesëmarrje në sporte të rrezikshme si parashutimi, alpinizmi, fluturimi me avion pa motor, zhytje nënujore, gara motorrike.
- h) Pjesëmarrjes së të siguarit në fluturime, përveçse si pasagjer në një avion të licencuar që i përket një shoqërie ajrore.
- i) Pjesëmarrjes e të siguarit në veprimtari kriminale, sulme apo veprime e kundërveprime të dhunshme.
- j) Defekteve mendore ose fizike të të siguarit që ekziston para fillimit të kësaj police, përveçse kur siguruesi është informuar dhe i ka pranuar me shkrim.

Primi, duhet paguar brenda datës së përcaktuar në Formular. Kjo policë do të jetë e papaguar nëse primi përkatës nuk është pagur brenda datës së përcaktuar. Siguruesi lejon një periudhë 10 ditore nga data e përcaktuar për pagesë, polica qëndron në fuqi gjatë periudhës së lejuar. Nëse primi nuk paguhet deri në fund të periudhës së lejuar atëherë polica përfundon prej datës së paracaktuar për pagesën e primit që nuk është paguar.

Me përfundimin e policës:

- a) Polica nuk ka vlerë;
- b) Mbulimi në sigurim i dhënë nga kjo policë merr fund.

5. Procedurat e kërkesave për dëmshpërblim / përfitim:

- a) Njoftimi i ngjarjes

Çdo ngjarje ose humbje që mund të rezultojë në një kërkesë për dëmshpërblim/përfitim do të duhet t'i raportohet me shkrim brenda 3 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes ose humbjes duke

specifikuar rrethanat dhe pasojat.

Nëse njoftimi nuk jepet brenda kësaj periudhe kohore atëherë kjo do të zhvlerësojë kërkesën për dëmshpërblim/përfitim nëse do të provohet se nuk ka qenë e mundur në mënyrë të arsyeshme të jepej ky njoftim dhe ky njoftim është dhënë sapo ka qenë e mundur.

Në rastet e një aksidenti gjate ushtrimit te detyres ose ne funksion te kryerjes se detyres, me pasojë vdekje apo dëmtime të rënda masive, punëdhënësi ose personi përgjegjës, i ngarkuar prej tij, pas dhënies së ndihmës së parë, duhet të ruajë provat materiale, për analizën e këtij aksidenti, dhe të lajmërojë menjëherë organet e Prokurorisë, Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Siguruesin.

Kur aksidenti ka ndodhur gjatë rrugës nga banesa për në punë dhe anasjelltas, procesverbali i mbajtur nga organet e policisë, duhet të bëhet pjesë e dokumentacionit, për përfitimin e pagesës së aksidentit në punë.

Aksidenti gjate ushtrimit te detyres ose ne funksion te kryerjes se detyres vërtetohet me procesverbalin e mbajtjes në vendin e ngjarjes dhe duhet të nënshkruhet nga punëdhënësi ose personi përgjegjës, i ngarkuar prej tij, si dhe nga përfaqësuesi i Siguruesit.

b) Prova e dëmtimit/humbjes

Prova me shkrim e dëmtimit/humbjes duhet t'i jepet Siguruesit sa më shpejt të jetë e mundur, brenda 30 ditësh nga njoftimi dëmtimit/humbjes, së bashku me kopjet origjinale të të gjithë dokumentacionit përkatës.

Personi i siguruar ose policëmbajtësi, me shpenzimet e tij, do t'i dorëzojë siguruesit në formën e kërkuar prej tij ato çertifikata, informacione dhe të dhëna që siguruesi do të kërkojë.

Siguruesi do të ketë të drejtën por jo detyrimin që me shpenzimet e tij, t'i kërkojë personit të siguruar të kryejë kontrollin mjekësor sa herë të jetë e nevojshme gjatë periudhës së trajtimit të një kërkesë për dëmshpërblim/përfitim.

c) Paga e dëmshpërblimit/përfitimit

Siguruesi do të trajtojë policëmbajtësit (Specializant i siguruar) si përfituesit ligjor të kësaj police, çdo shumë e pagueshme sipas kësaj police do të paguhet me kërkesë të policëmbajtësit.

Kërkesa për dëmshpërblim/përfitim mashtrues

Nëse ndonjë kërkesë për dëmshpërblim/përfitim sipas kësaj police do të ketë ndonjë aspekt mashtrimi ose nëse policëmbajtësi, Punonjësi i Siguruar apo çdokush që vepron në emër të tyre do të përdorë mjete mashtrimi, atëherë siguruesi nuk do të ketë përgjegjësi për kërkesa të tilla.

6. Parashikime të tjera

a) Kufijtë gjeografikë, përcaktojnë mbulimin me siguri të këtij sigurimi, e vlefshme për territorin Shqiptar.

- b) Plotësimi i kushteve të Sigurimit – Në rast se nuk plotësohet ndonjë nga kushtet e kësaj police, atëherë të gjithë kërkesat për dëmshpërblim/përfitim do të bëhen të pavlefshme.
 - c) Përfundimi – Policëmbajtësi dhe siguruesi mund të përfundojnë këtë policë duke dhënë njoftim paraprak me shkrim të paktën 30 ditë më parë. Polica do të konsiderohet e anuluar me përfundimin e 30 ditëve nga marrja e këtij njoftimi.
 - d) Juridiksioni – Çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë Sigurim që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim të dyanshëm do të jetë subjekt i legjislacionit Shqiptar dhe Gjykatës së Rrethit Tiranë.
7. Kthimi I Polices
- a) Në rast se kërkohej nga Autoriteti Kontraktor për shkaqe të ndryshme.
 - b) Nuk do të llogariten shpenzime administrative
 - c) Mbajta e primit për policën e sigurimit të përdorur, do të jetë me bazë 1 muaj

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Lista emërore e specializanteve, do të vihet në dispozicion operatorit ekonomik i shpallur fitues.

Specializantët pas lidhjes së kontratës do të kenë poicën e sigurimit individuale.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

Shërbim:

Dokumentat standarde të tenderit

Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Sigurimi i shëndetit të studentit specializant

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **Sigurimi i shëndetit të studentit specializant**

Detyrat: **Sipas Shtojces 9, specifikimet teknike.**

Shpërndarja: **Sipas Shtojces 9, specifikimet teknike.**

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Fakulteti Mjekesise, Tirane dhe Fakulteti Mjekesise Dentare, Tirane

Loti II

Sigurimi i përgjegjësisë profesionale dhe personale të studentit specializant.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1;*
- b. *Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1*
- c. *Sigurimi i ofertes, (nëse është i zbatueshëm) sipas Shtojcës 3;*

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 7/1;

e. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor),

3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

1. Ofertuesi duhet të jetë kompani sigurimesh, e cila të përmbushë të gjitha kërkesat e Legjislacionit të fushës, e pajisur me leje për ushtrim të aktivitetit sigurime dhe/ose risigurime nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, ku të jenë specifikuar qartë grupet/klasat për sigurimet e kërkuara në këtë tender dhe ne specifikimet teknike.

3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të lotit.

2. Kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: 2016, 2017, 2018, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

3.3 Kapaciteti teknik:

1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 30% të vlerës së fondit limit.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon dokumentacionin si më poshtë:

c) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

d) Fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

Sigurimi i përgjegjësisë profesionale dhe personale të studentit specializant.

Mbulimi i Përgjegjësisë profesionale dhe Personale të studentit (specializantit) për dëmtime që i shkakton palëve të treta gjatë periudhës së specializimit dhe ushtrimit të detyrave të parashikuara në programin specializues.

1. Kjo policë shërben për dëmshpërblimin e të siguruarit në lidhje me përgjegjësinë e tij ligjore profesionale kundrejt palëve të treta, për çdo kërkesë të palëve të treta, e cila plotëson kushtet e mëposhtme:

Çdo kërkesë për dëmshpërblimin e palëve të treta duhet:

- i. Të bëhet për dëme dhe me qëllim marrjen e kompensimit, si dhe shpenzimet e mbrojtjes të miratuara nga i Siguruari;
- ii. Të jetë ngritur kundrejt të Siguruarit gjatë afatit të policës së sigurimit;
- iii. Të bëhet për dëme të mirëfillta financiare, që rrjedhin nga një veprim, gabim ose mosveprim, si pasojë e neglizhencës, të kryer nga i Siguruari gjatë afatit të sigurimit;
- iv. Të ketë ndodhur në rrjedhën e përmbylljes së zakonshme të shërbimeve profesionale nga i Siguruari, ose nga çdo person tjetër, që vepron në emër të tij me cilësinë e avokatit/juristit;
- v. Të ketë lidhje me një veprim, gabim ose mosveprim, si pasojë e neglizhencës, që ka ndodhur, ose mund të ketë ndodhur pas datës prapavepruese të përcaktuar në formularin e policës.

2. Kufiri i përgjegjësisë

Kufiri maksimal për dëme të kombinuara (për dëmtimet trupore, dëmtime pasurore dhe dëmtimeve personale) do të jetë në total 5.000.000 Lekë dhe për çdo ngjarje deri në 5,000,000 leke për çdo student specializant.

3. Afati kohor

Afatikohor i policës do të jetë për një periudhë 1 vjeçare për studentet në vazhdimësi dhe për studentet që e kanë të përcaktuar afatin e perfundimit të studimeve, kontrata do lidhet bazuar në keto afate kohore (Përcaktuar të numeri i studenteve)

- *Në rast se një specializant ndërpret studimet, për atë specializant, të bëhet kthim primi për pjesën e mbetur, pa pretenduar mbajtje për shpenzime administrative, por vetëm llogaritjen në bazë ditore të shfrytëzimit të policës, nëse ky Specializant nuk ka përfituar nga kjo policë.*

4. Policëmbajtësi

Në policën e sigurimit **policëmbajtës** do të jetë specializanti

5. **Kushtet e përgjithshme** të sigurimit do të jenë të bazuara në Kodin Civil, Ligjin 52/2014, për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit dhe udhëzimet e nxjerra nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

a. Numri i studentëve

Nr	Emërtimi	Njesia	Nr. i specializanteve		Total Nr i specializantëve	Nr.Ditë per tu siguruar për çdo st.specializ.
			FM	FMD		
1	Sigurimi i përgjegjësisë profesionale dhe personale të specializantëve/studentëve gjatë ushtrimit të detyrës/ Mbrojtje deri 5,000,000 lekë	Persona	576	22	598	366
		Persona	80		80	183
		Persona	17		17	305
		Persona	5		5	246

- *Limitet e përgjegjësisë së çdo specializant do të jenë:*
 - a. *Sigurimi i përgjegjësisë profesionale dhe personale të studentit specializant, mbulimi deri 5,000,000 lekë.*
- *Kërkohet edhe primi ditor me të njëjtat limite përgjegjësie.*

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Lista emërore e specializanteve, do ti vihet në dispozicion operatorit ekonomik i shpallur fitues.

Specializantët pas lidhjes së kontrtës do kenë poicën e sigurimit individuale.

Shtojca 10

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

--

Dokumentat standarde të tenderit

Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: **Sigurimi i përgjegjësisë profesionale dhe personale të studentit specializant**

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **Sigurimi i përgjegjësisë profesionale dhe personale të studentit specializant**

Detyrat: **Sipas Shtojces 9, specifikimet teknike.**

Shpërndarja: **Sipas Shtojces 9, specifikimet teknike.**

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Fakulteti Mjekesise, Tirane dhe Fakulteti Mjekesise Dentare, Tirane

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të*

Dokumentat standarde të tenderit

shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Dokumentat standarde të tenderit

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____
2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES

Shërbimet – Procedura e Hapur

Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës së hapur.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2 Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
